



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 252, Datë 08.10.2025

MBI

“NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 192, DATË 12.08.2025, PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT TË ERE-S PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË “SPV BLUE 2” SH.P.K. SI MJET PËR GARANTIMIN E PËRMBUSHJES SË DETYRIMIT NDAJ BANKA E TIRANËS SH.A., BANKA OTP ALBANIA SH.A., INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA SH.A. DHE UNION BANK SH.A.”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 08.10.2025, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 2199/4 prot., datë 30.09.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 192, datë 12.08.2025, mbi kërkesën e shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k. për dhënien e autorizimit për barrësimin e kuotave të saj (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) me qëllim garantimin e shlyerjes së detyrimeve të lindura nga kontrata e kredisë sindikale në favor të “Banka e Tiranës” sh.a., “Banka OTP Albania” sh.a., “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a. dhe “Union Bank” sh.a.”,

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “SPV Blue 2” sh.p.k.

- Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 296 në datë 30.12.2024 është licencuar shoqëria “SPV Blue 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku fotovoltaik “Blue 2”, me kapacitet prodhimi 50 MW, me vendndodhje në Sheq Marinas.
- Ndërsa me vendimin nr. 192, datë 12.08.2025, bordi i ERE-s, ka miratuar dhënien e autorizimit për barrësimin e kuotave të saj (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) me qëllim garantimin e shlyerjes së detyrimeve të lindura nga kontrata e kredisë sindikale në favor të “Banka e Tiranës” sh.a., “Banka OTP Albania” sh.a., “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a. dhe “Union Bank” sh.a., ku Agjent i Kredisë dhe i kolateralit është zgjedhur “Banka e Tiranës” sh.a., duke përcaktuar: *1. Dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k. si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Banka e Tiranës” sh.a., “Banka OTP Albania” sh.a., “Intesa Sanpaolo Bank Albania”*

sh.a. dhe “Union Bank” sh.a., ku Agjent i Kredisë dhe i Kolateralit është zgjedhur “Banka e Tiranës” sh.a. (sipas kontratës së kredisë sindikale nr. 4338 Rep., nr. 1877 Kol., datë 30.05.2025). 2. Dhënia e Autorizimit nga ERE sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi nuk e çliron shoqërinë “SPV Blue 2” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe. 3. Shoqëria “SPV Blue 2” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi në të i vendosjes së kolateralit mbi kuotat e saj. 4. Shoqëria “SPV Blue 2” sh.p.k. të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm. 5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

- ERE me shkresën nr. 2199/2 prot., datë 13.08.2025, njoftoi shoqërinë për vendimin e sipërcituar, dhe i solli në vëmendje mbajtjen në konsideratë të plotësimit të kushteve të lëna në këtë vendim.

2. Dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Me shkresën nr. 2199/3 prot., datë 02.09.2025 shoqëria ka bërë me dije se ka pasqyruar në ekstraktin historik në QKB “Marrëveshjen Siguruese” konform kërkesave të pikës 3 të vendimit nr. 192/2025.

3. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi

- Duke marrë në konsideratë përcaktimet e vendimit të bordit të ERE nr. 192, datë 12.08.2025, rezulton se shoqëria “SPV Blue 2” sh.p.k. ka përmbushur kushtin e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, pasi ka bërë me dije se ka pasqyruar në ekstraktin historik në QKB “Marrëveshjen Siguruese” konform kërkesave të pikës 3 të vendimit nr. 192/2025.
- Përditësimi i ekstraktit historik të regjistrit tregtar është kryer më datë 27.08.2025 dhe ERE është informuar brenda afatit 10-ditor të përcaktuar në pikën 3 të vendimit të bordit, duke respektuar plotësisht kërkesat e vendimmarrjes.
- Në këto kushte, vlerësohet se pika 3 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 192, datë 12.08.2025 duhet të shfuqizohet, pasi objekti i saj është përmbushur plotësisht dhe nuk ka më nevojë për ndjekje të mëtejshme institucionale.

4. Nevoja për Ndryshimin e Vendimit

- Në mbështetje të nenit 113 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të shfuqizohet nga organi publik që ka kompetencën për ta nxjerrë, vlerësohet se pika 3 e vendimit të bordit të ERE nr. 192, datë 12.08.2025, duhet të shfuqizohet.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 3 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 192, datë 12.08.2025, shfuqizohet.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “SPV Blue 2” sh.p.k për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI